

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 MARS 2003**

T R A N S K R I P T

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 13. 03. 2003. GODINE**

**MARS – MART
2003**

TRANSKRIPT

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 13 MARS 2003**

(KJO SEANCË ËSHTË VAZHDIM I SEANCËS SË DATËS
6 MARS 2003 ME REND TË NJËJTË TË DITËS)

Seanca filloi punën në orën 10,00.

**KRYESUES I SEANCËS, AKADEMIK NEXHAT DACI,
KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.**

**BASHKËKRYESUES XHAVIT HALITI, ANËTAR I
KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS.**

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në seancën e radhës plenare.

Materialin e kemi të gjithë, sepse është ai i njëjti i para një jave.

Pikë e parë e rendit të ditës është – Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.

A ka kush ndonjë vërejtje apo sygjerim? Nuk ka. Ju falemnderit.

Pika vijuese është – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridikë në bankrotim.

Ndërrimi i pikave të rendit të ditës është bërë meqë Kryeministri është i zënë në një takim të rëndësishë së veçantë për Kosovën e që është përcaktuar shumëkohë më parë dhe nuk ka qenë e mundur që t'levizë. Diku rreth orës 11,30 do të jetë i lirë Kryeministri.

Ne, për të mos humbur kohë, po procedojmë me shqyrtimin e Ligjit e pastaj vazhdojmë me fjalën e Kryeministrit.

Shpresova, të nderuar deputetë, se jeni të informuar për këtë dhe është theksuar në materialet tuaja, e nëse jo, kërkoj falje.

Procedojmë me shqyrtimin përfundimtar të dytë të Projektligjit.

Mendoj se deputetët i kanë materialet për këtë Ligj dhe të fillojmë me shqyrtimin e amendamenteve si vijon:

Amendamenti 1.

I propozuar nga deputetja Nerxhivane Dauti, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe Komisioni funksional.

Do të thotë një amendament që ka përkrahjen faktikisht të tërë strukturës vepruese në Parlament dhe më mbetet vetëm t'ju pyes:

**Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Konstatohet se njëzërit u aprovua amendamenti i parë.

Amendamenti 2.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 3.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Para se t'ju pyes – kush është për, ju lutem t'i ç'kyçni celularët që të mos interferojnë..

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 4.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Amendamenti 5.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 6.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për këtë amendament?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Ju falemnderit.

Amendamenti 7.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për këtë amendament?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Ju falemnderit.

Amendamenti 8.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për këtë amendament?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Ju falemnderit.

Amendamenti 9.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për këtë amendament?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 10.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për këtë amendament?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 11.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 12.

Dy propozime të ndryshme:

- a) Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, dhe nën
- b) Deputetja Nerxhivane Dauti.

Kush është për propozimin nën a) të Komisionit për buxhet dhe Komisionit për financa dhe ekonomi?

Ju falemnderit. Shumica absolute. Megjithatë, duhet t'i numërojmë votat.

A ka kush kundër?

Udhëroni, zonja Dauti.

NERXHIVANE DAUTI:

Janë dy propozime të ndryshme, por jo të ndryshme në pikëpamje të ndonjë kundërthënie të paraqitur. Janë të ndryshme në pikëpamje të nenit 11.2 që i referohet pikës c) nën 1 dhe 2, është propozim imi, por jo në kundërthënie. Pra këto dy propozime duhet të votohen veç e veç. I pari është i komisioneve, i dytë është imi.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Edhe një herë, ju lutem.

Kush është për propozimin e Komisionit për buxhet dhe Komisionit për financa dhe ekonomi?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Katër abstenime.

Sipas sqarimit tuaj, profesoreshë, duhet ta votojmë edhe propozimin tjetër.

Kush është për propozimin e deputetes Nerxhivane Dauti, me sqarimet plotësuese?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 13.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush s'është kundër.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 14.**Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****Kush është kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.****Amendamenti 15.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.****Amendamenti 16.****Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.****Amendamenti 17.****Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Një abstenon.
Ju falemnderit.

Amendamenti 18.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 19.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 20.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.

Amendamenti 21.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?

Udhëroni, për sqarim.

ISMAJL KURTESHI:

E nderuar Kryesi dhe deputetë,

Ne, pak më herët, kapërcyem si shpejt një çështje kështu më shumë terminologjike: “kërkesat e palejuara” që nuk tingëllon mirë logjikisht. Edhe në këtë rast kemi “kërkesa me dhunë” – “kundërshtimi i ankesave dhe kërkesa me dhunë”. Kujtoj se formulimi nuk është i drejtë. Duhet të jetë: “kundërshtimi i ankesave dhe përdorimi i dhunës” apo të fshihet “kërkesa me dhunë” sepse kërkesa me dhunë apo kërkesat e palejuara nuk tingëllojnë mirë logjikisht. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të falemnderit. Ju lutem le të lektorohet dhe redaktohet, në varshmëri me atë që u propozua dhe vërejtja është me vend.

Domethënë, amendamenti miratohet me këtë propozim.

Amendamenti 22.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

Kush është për?

Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 23.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 24.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 25.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 26.

Komisioni për buxhet dhe komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 27.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 28.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 29.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 30.**Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 31.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 32.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 33.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.**

Amendamenti 34.**Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.****Amendamenti 35.****Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 36.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 37.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.**

Amendamenti 38.**Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 39.****Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.****Amendamenti 40.****Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.****A abstenon ndokush? Askush.****Amendamenti 41.****Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.****Kush është për?
Ju falemnderit.****A ka kush kundër? Askush.**

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 42.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush nga votimi? Një abstenim.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 43.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 44.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për?

Urdhëroni, për sqarim.

ISMAJL KURTESHI:

Këtu thuhet, të ndryshohet fjala “zbatimit” me fjalën “implementimit”. Kujtoj që edhe këtu mund të bëhet zëvendësimi i përshtatshëm me fjalën shqipe “jetësimit” ose “realizimit”, por më shumë i përshtatet “jetësimit” në vend të “implementimit”. Edhe “zbatimit” mund të shkojë, por nuk ka nevojë të përdoret - “implementim”.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Unë do të them, le të konsultohen gjuhëtarët dhe të jetë vendimtare ajo. Ju falemnderit.

Kush është për amendamentin 44 me propozimin e dhënë nga deputeti Kurteshi për korrigjim të nevojshëm?

Ju falemnderit.

Kush është kundër? Askush.

A abstenon ndokush nga votimi? Dy abstenime.
Ju falemnderit.

Amendamenti 45.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

Kush është për?
Ju falemnderit.

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 46.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 47.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

**A abstenon ndokush? Askush.
Ju falemnderit.**

Amendamenti 48.

Deputetja Nerxhivane Dauti, e përkrahur nga komisionet kryesore dhe komisionet funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 49.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Amendamenti 50.

Komisioni për buxhet dhe Komisioni për financa dhe ekonomi, i përkrahur nga komisionet kryesore dhe funksionale.

**Kush është për?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Askush.

A abstenon ndokush? Askush.

Ju falemnderit.

Tani duhet ta votojmë Ligjin në tërësi.

**Kush është për Ligjin në tërësi, i lutem le të çojë dorën?
Ju falemnderit.**

A ka kush kundër? Nuk ka votë kundër.

A abstenon ndokush nga votimi? Askush.

Të pranishëm janë 84 deputetë, prandaj konstatoj se Ligji u miratua.

Votimi – Glasanje – Voted:

Për – Za – For:.....	Të gjithë – Svi – All.
Kundër – Protiv – Against.....	0 0
Abstenuan – Uzdržanih – Abstained.....	0 0

(Duartrokitje)

Tash do të kemi një pauzë deri në orën 11,30 dhe atëherë shpresojmë do të arrijë edhe Kryeministri.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kolegë deputetë, më lejoni t'i dëshiroj mirëseardhje Kryeministrit të Kosovës doktor Bajram Rexhepit dhe menjëherë t'ia jap fjalën dhe të paraqet raportin e përgatitur të Qeverisë për punën njëvjeçare. Udhëroni zoti Kryeministër, foltorja është juaja.

BAJRAM REXHEPI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Fillimisht kërkoj falje për dy çështje, një që u vonova pak sot për këtë ekspozë, këtë për arsye se tre muaj më parë është aranzhuar, dhe si e dini, Kosova ka hyrë në një proces drejt stabilizim-asocimit nëpërmjet mekanizmit përcjellës, prandaj këtu është Komisioneri i Komisionit Evropian për Çështje të Evropës Juglindore dhe është takimi i parë zyrtar. Pra, Kosova shkon në rrugën e vet, ndaras nga shtetet e regjionit në një nivel më të ulët, prandaj ajo ishte arsyeja. Dhe kërkimi i faljes tjetër – është për zërin tim që në këtë moment jam pak gripoz, por nuk do të kursehem dhe ndoshta s'do të kam pengesa. Do t'ia kisha lakmi zotit Mahmut Bakalli që bile në nivelin e zërit të tij sot të isha në gjendje të flasë!

Edhe një herë, i nderuar zoti kryetar dhe të nderuar deputetë,

Pas një viti të formimit të Qeverisë, sot jam para jush për ta vlerësuar punën, obligimet dhe përgjegjësitë që kemi marrë përsipër për t'i kryer. Është kjo kohë e duhur për të vlerësuar përparimin e gjithmbarshëm në kalimin e një vendi të shkatërruar nga lufta në një shoqëri ku të gjithë njerëzit mund të presin me të drejtë që të jetojë një jetë normale dhe të kenë gjithmonë shansa për një jetë më të mirë. Tashmë, pjesa dërrmuese e shkatërtimeve të luftës është riparuar, duke iu falënderuar, në radhë të parë, miqve ndërkombëtarë, bashkëatdhetarëve në diasporë dhe vetëmohimit të qytetarëve tanë.

Formimi i Qeverisë, si rezultat i marrëveshjes së 28 shkurtit 2002, ndërmjet subjekteve kryesore politike, të përfaqësuara në Kuvend, krijoi një bazë solide për ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve të Kosovës, të njohura dhe të pranuar nga faktori ndërkombëtar. Në fillim të kësaj marrëveshjeje, që do ta vlerësoja si të arritur të madhe për Kosovën, në kuptimin e menaxhimit politik e demokratik të vendit, pati shumë hezitime, dyshime, madje edhe pesimizëm, do të thoja, se ky ndërtim institucional demokratik nuk do të ketë shansa për të funksionuar.

Ne të vërtetë, sot, pas një viti pra, të gjithë jemi dëshmitarë se këto institucione janë duke funksionuar dhe tashmë kemi edhe suksese të theksuara përkundër vështirësive të shumta.

Më lejoni që në pika të shkurtëra t'i theksoj disa aktivitete të Qeverisë:

1. Konsolidimi i Qeverisë dhe i administratës transparente;
2. Krijimi i një klime stabile dhe të sigurtë për të gjithë qytetarët e Kosovës;
3. Përfaqësimi i Kosovës në Paktin e Stabilitetit;
4. Programi i kompletuar i Qeverisë, i përkrahur dhe mbështetur nga institucionet e rëndësishme ndërkombëtare financiare;
5. Aktiviteti për hapjen e zyrës së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, këtu në Prishtinë;
6. Zgjerimi i politikës fiskale, duke rritur burimet e të hyrave në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës;
7. Përkujdesja sociale ndaj kategorive të rrezikuara;
8. Marrëveshjet për tregti, nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet ministrive tona dhe të shteteve fqinje;

9. Strategjia e bashkëpunimit të Qeverisë së Kosovës me pushtetet lokale, me UNMIK-un, përkatësisht me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, për integrimin e komuniteteve në jetën politike, publike dhe ekonomike;
10. Rezoluta për komunitete;
11. Krijimi i një identiteti të qëndrueshëm politik e shtetëror;
12. Përkujdesja për ruajtjen e ambientit;
13. Angazhimi i Qeverisë në çështjet e luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar e trafikeve ilegale dhe Deklarata kundër korrupsionit;
14. Bashkëpunimi i Qeverisë me organizmat vendorë e ndërkombëtarë;
15. Konferenca e Donatorëve në Bruksel;
16. Konferencat për investimet e organizuara nga Qeveria në disa shtete;
17. formimi i Këshillit Ekonomik Fiskal;
18. Formimi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit;
19. Shkrirja e Autoritetit Qendror Fiskal në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Në shumicën e këtyre gjërave Qeveria ka pasur rol aktiv dhe normalisht se nuk kemi mund t'i formojmë vetë por në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, pra me UNMIK-un.

Në kuadër të aktiviteteve tjera me jashtë, do të veçoja:

- Vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe takimin me Sekretarin e Shtetit Kollin Pauell;
- Takimi me G-8-shin në Kanada;
- Mekanizmin përcjellës për stabilizim-asocim, dhe sot është hera e parë që në Kosovë është organizuar;

- Aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me specifikat e veçanta në çdo ministri të Qeverisë së Kosovës, e që nuk po i përmend tash.

Ekonomia e vendit, megjithë vështirësitë, ka shënuar përparim të dukshëm, duke iu ofruar njerëzve mundësinë për të pasur standarde jetësore më solide.

Qeveria ka marrë veten shpejt për të filluar nxjerrjen dhe fuqizimin e ligjeve të nevojshme, për ta përkrahur dhe ndihmuar shoqërinë. Deri më tash ia kemi parqitur Kuvendit 18 projektligje, ndërsa mbi 20 projektligje tjera janë në fazën përfundimtare për aprovim në Qeveri e më pas t'i përcjellë në Kuvend. Në këtë drejtim dihen edhe vështirësitë rreth procedurave për hartimin e ligjeve dhe dërgimin e tyre në Kuvend. - Qeveria dhe Kuvendi janë dakorduar që të krijojmë sa më shumë ligje dhe në vazhdimësi do të insistojmë te PSSP-a për t'i nënshkruar ato.

Vlenë të theksohet gjithashtu se bashkëpunimi ndërinstitucional Qeveri – Kuvend ka qenë në rritje të vazhdueshme dhe tashmë jemi në fazën e një kooperimi të plotë institucional.

Nga aktivitetet e ministrive për vitet 2002-2003 do t'i veçoja disa prej tyre.

Nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësiror duhet theksuar:

- Projektin për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm;
- Hartimin e dokumentacionit për planifikim hapësiror;
- Programet sociale për banim;
- Krijimin e zonave për vendbanime të reja dhe për zona industriale;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqesë edhe 6 projektligje.

Nga Ministria për Ekonomi e Financa:

- Korniza afatmesme e shpenzimeve;
- Kalimi i kompetencave në komuna për qeverisje të mëvetësishme;
- Hartimi dhe miratimi i Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2003;
- Themelimi i Departamentit të Analizave Makroekonomike;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqet edhe 6 projektligje.

Nga Ministria e Shërbimeve Publike:

- Ndërtimi i Institutit për Administratë Publike;
- Krijimi i hapësirave për instituconet e Kosovës;
- Pajisja me dokumentacione dhe patentshoferë;
- Prodhimi i tabelave të automjeteve;
- Divizioni i Menaxhimit Emergjent;
- Agjencioni Qendror i Prokurimit;
- Agjencioni Kadastral i Kosovës;
- Anti Statistikor i Kosovës;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqet edhe 21 projektligje.

Nga Ministria e Transportit dhe Tregtisë:

- Kontributi dhe rekomandime në proces të privatizimit, në sistemin doganor, në KEK, miniera, etj.;
- Themelimi i Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve;
- Zbatimi i Urdhëresës për lojërat e fatit.

Nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale:

- Ngritja e administratës pensionale të Kosovës në shtatë zyra rajonale;
- Në bashkëpunim me administratën e UNMIK-ut janë liruar nga borxhet e KEK-ut familjet që janë në asistencë sociale;
- Hartimi i politikave sociale;
- Në mbrojtje sociale gjatë këtij viti janë përfshirë 51.000 familje;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqet edhe 5 projektligje.

Nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Hartimi i Planit të përgjithshëm afatgjatë për zhvillimin e arsimit;
- Themelimi i Fakultetit të Edukimit;
- Sigurimi i të drejtave të barabarta për shkollim për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa kurrfarë dallimesh;
- Sigurimi i hapësirës së nevojshme për shkollim.

Nga Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente:

- Hartimi i strategjisë së zhvillimit kulturor të Kosovës;
- Inventarizimi i trashigimisë kulturore e historike;
- Krijimi i rrjetit të institucioneve për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashigimisë kulturore;
- Organizimi i konferencave investime me diasporën në disa shtete;
- Projekte të shumta rinore e sportive;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqet edhe 11 projektligje.

Nga ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit:

- Vendosja e kontakteve me vendet fqinje;
- Funkcionimi i stacioneve të autobusëve;
- Vendosja e bashkëpunimit me Shërbimin Policor të Kosovës për asistim të policisë në inspektimin e automjeteve;
- Fillimi i punës së Akademisë së Instruktorëve;
- Licencimi i autoshkollave dhe instruktorëve;
- Kompletimi i qendrave rajonale të patent-shoferit me personel dhe mjete, organizimi i provimeve;

- Departamenti i infrastrukturës rrugore;
- Divizioni i postës;
- Divizioni për politikën e transportit hekurudhor e ajror;
- Për vitin 2003 kjo Ministri do të paraqet edhe 13 projektligje.

Nga Ministria e Shëndetësisë për vitin 2003 do të paraqiten 5 projektligje.

Nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2003 do të paraqiten edhe 14 projektligje.

Në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës dhe TMK-ës, mund të thuhet me përgjegjësi se ato janë duke orfuar një ndihmë të çmuar për sigurinë e Kosovës.

Komunat po kryejnë punën e tyre, partitë politike dhe shoqëria civile po i vënë bazat për demokraci dhe sistemi ligjor po forcohet.

Bashkëpunimi me UNMIK-un dhe PSSP ka qenë vazhdimisht në nivel, përkundër mospajtimeve të kohëpaskohshme.

Përparësitë e këtyre të arriturave janë në të mirë të të gjithë njerëzve. Por fatkeqësisht ka ende edhe të atillë që nuk përfitojnë apo nuk janë të kyçur në ndërtimin e kësaj shoqërie të re.

Shumë qytetarë, me të drejtë legjitime për të jetuar këtu, mbesin prapa kufijve të vendit tonë të frikësuar për t'u kthyer në shtëpi apo të cilët nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë, për shkak se iu mungojnë mjetet për ta ndihmur veten e tyre. Në anën tjetër, ne duhet t'i bindim të gjithë ata atë cilët dyshojnë apo frikësohen se ne synojmë të krijojmë një shoqëri ku të gjithë do të kenë mundësi për të jetuar në paqë. E kaluara e frikshme nuk guxon të përsëritet më. E ardhmja jonë është që të jemi shoqëri moderne, një ditë pjesë e Unionit Evropian dhe pjesë e integritimeve euroatlantike.

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Ne mund të mburremi me vitin që shkoi. Ka pasur frustrime dhe ka ende probleme, mirëpo, ka pasur përparime të dukshme.

Ne duhet të jemi realist në vlerësimin e asaj që mbetet të bëhet dhe në pengesat që duhet doemos të tejkalohen.

Komuniteti ndërkombëtar po zvogëlon praninë dhe ndihmën e vet në Kosovë. Në ditët dhe muajt e ardhshëm ne do të marrim më shumë kompetenca, të cilat do ta testojnë aftësinë dhe këmbënguljen tonë. Konkretisht, këtyre ditëve ne kemi patur takime të para me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për transferimin e kompetencave. Qeveria e Kosovës ka hartuar një strategji për bartjen e kompetencave në ato fusha që ka konsideruar të domosdoshme. Në këtë drejtim vlen të theksohet se Qeveria ka kërkuar marrjen e kompetencave në të gjitha ndërmarrjet publike, duke kyçur PTK-ën, KEK-un, formimi i Aerokompanisë, frekuencat, çështjen e privatizimit, lëshimi ne dokumentacioneve, duke mos harruar në këtë drejtim as diasporën shqiptare.

Ne kemi kërkuar gjithashtu një afrim më të madh ndërmjet UNMIK-ut dhe Qeverisë edhe në ato fusha ku kompetencat janë të rezervuara për PSSP-ën. Konkretisht, kemi kërkuar pjesëmarrje në fushën e politikës së jashtme, çështjen e punëve të brendshme, në drejtësi, në siguri, në energjetikë dhe në miniera, në mënyrë që sa më shpejt të jetë e mundur të kemi formimin e ministrive të reja. Gjithashtu kemi bërë të qartë se aktivitetet dhe mundësitë e Qeverisë së Kosovës, në shumë raste, kufizohen nga Korniza kushtetuese dhe për këtë shkak kemi paralajmëruar që në bashkëpunim me Kuvendin dhe institucionet tjera do të bëjmë edhe ndryshimin e Kornizës kushtetuese në favor të avancimit të proceseve shoqërore, politike dhe ekonomike.

Qeveria është ballafaquar dhe do të ballafaqohet edhe me më shumë sfida. Në vitin që vjen dhe më pas, institucionet tona janë gati dhe të afta për t'i marrë përgjegjësitë e reja. Nëpunësit tanë civilë kanë nevojë për trajnim dhe këshilla. Atyre po ashtu iu duhen rroga më të mëdha. Nuk mund të presim persona të kualifikuar të punojnë në Qeveri me këto paga që janë. Institucionet tona mund të funksionojnë me më shumë efikasitet kur kanë staf të kualifikuar. Ne dëshirojmë që fëmijët tanë të kenë mësues, të cilët mund t'i edukojnë më mirë, në mënyrë që ata të mund ta realizojnë potencialin e tyre. Ne duam shërbime mjekësore që janë kompetente; jetë kulturore e sportive më të pasur. Ne duam që rinia jonë të ketë hapësirë dhe mundësi për t'u marrë me aktivitete të shumta. Për të gjitha këto, duhet të kemi mjete më shumë dhe të krijojmë kushte më të mira.

Ekonomia jonë varet nga shumë faktorë. Për këtë shkak, ne kemi strategjinë tonë për t'i larguar pengesat në zhvillimin ekonomik, për t'i inkurajuar investimet nga vendorët dhe investitorët e jashtëm në ndërmarrjet prodhuese.

Varshmëria jonë ekstreme nga importi, është e paperspektivë dhe e paqëndrueshme. Shumë nga gjërat e importuara, mund të prodhohen këtu. Biznesi ynë po ashtu duhet të prodhojë për tregje të jashtme. Ne duhet të kërkojmë që të largojmë

barierat aktuale në eksportin kosovar. Sepse, vetëm duke qenë prodhues, ne mund të konkurojmë në rajon dhe vetëm në këtë mënyrë mund të krijojmë vende pune për popullatën tonë të re, për fëmijët tanë.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore është në rrugë e sipër dhe ne do t'i tërheqim investitorët për themelimin e ndërmarrjeve prodhuese private, të cilët do të sjellin teknologji të reja. Në këtë përpjekje, do të na nevojiten medoemos burimet e institucioneve ndërkombëtare financiare. Pa këto burime, është joreale të pritët rehabilitimi i infrastrukturës apo zhvillimi i biznesit.

Rrjetet e krimit të organizuar, po përdorin territorin tonë dhe njerëzit si mburojë për aktivitetet e tyre. Ata përhapin frikë te kosovarët dhe na japin të gjithë neve imazh të keq në botë ku ne duam rrespekt dhe barazi.

Sistemi ynë ligjor duhet të funksionojë më mirë për t'i mbrojtur njerëzit dhe vlerat njerëzore. Në veçanti gjykatat duhet të jenë më të matura dhe të kujdesshme për të mos e vënë drejtësinë në shërbime të njëanshme dhe në shërbim të dëshmitarëve apo dëshmitarëve të rrejshëm.

Kosovarët duhet të kyçen më shumë në subjekte politike për t'i ndihmuar liderët e tyre dhe proceset në përgjithësi. Qytetarët e Kosovës duhet të jenë më aktivë. Ata duhet të sigurohen që institucionet tona dëgjojnë. Sepse, ne s'mund të kemi demokraci nëse njerëzit nuk ushtrojnë të drejtat e tyre dhe nëse nuk kërkojnë nga ata që iu shërbejnë të veprojnë sipas vullnetit të popullit. Kjo është një formulë e thjeshtë por e domosdoshme për ta bërë Kosovën.

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Kemi edhe një detyrë për ta filluar tash. Ne dijmë se çështja e statusit final duhet të adresohet drejtpërdrejt në kohë të duhur dhe në përputhshmëri me disponimin e favorshëm të faktorit ndërkombëtar. Ne duhet të fillojmë të përgatitemi për kohën kur komuniteti ndërkombëtar do të ulet me ne dhe me Serbinë e Malin e Zi për të zgjidhur këtë çështje, e cila është fundamentale për ekzistencën tonë, për të ardhmen tonë. Në pjesë e kësaj, ka të bëjë me forcimin e shoqërisë demokratike të cilën ne po e ndërtojmë, një pjesë është krijimi i ekonomisë, e cila mund të përkrahë qytetarët tanë dhe një pjesë ka të bëjë me të kaluarën dhe ndarjet etnike, të cilat vazhdojnë të kërcenojnë sigurinë tonë.

Këto aspekte do të na ndihmojnë shumë për ta bindur botën për përgjegjësinë tonë, për t'i kryer punët tona. Por ne duhet, po ashtu, të përgatisim pozicionet tona për negociatën. Tashmë është aktuale kërkesa për dialog të mundshëm mes Beogradit dhe Prishtinës, me përfaqësues të institucioneve vendore për çështje teknike, si thuhet.

Nismat e tilla, në parim, janë të mirëseardhura. Por, një gjë duhet të bëhet e qartë dhe paekuivoke. Institucioni i Qeverisë nuk mund të bëjë dialog, nëse për një çështje të tillë nuk ka kompetencë, nëse nuk jemi të barabartë me palën tjetër dhe në qoftë se nuk kemi një mekanizëm për kontroll të plotë të çështjeve të tilla. Mirëpo, meqë në këtë rast është fjala për dialog midis Prishtinës dhe Beogradit, pesha dhe përgjegjësia për ne shumëfishohet. Unë, si kryeministër i Kosovës, nuk mund të vëhem në pozitë për të bërë hapa të tillë në këtë drejtim, pa pëlqimin e plotë të subjekteve kryesore politike të Kosovës, sepse, në fund të fundit, për një gjë të tillë më obligon edhe marrëveshja e 28 shkurtit. Kur të jenë sqaruar këto çështje dhe vetëm atëherë kur Kuvendi të japë dritë jeshile dhe të kihet një strategji, Qeveria ka mundësi ta vë në lëvizje mekanizmin e vet ekzekutiv. Procedurat e tilla kanë një peshë të veçantë për të dëshmuar ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Pikat, të cilat zoti Shtajner i ka përcaktuar si temë të diskutimeve, janë rrahur disa herë ndërmjet UNMIK-ut dhe Beogradit. Lind pyetja, çfarë kërkohet prej nesh? Vetëm brenda 7 ditësh Beogradi filloi çështjen e dialogut me kërkesa teknike dhe përfundoi me ndarjen e Kosovës. Nuk është vështirë për të kuptuar se shteti fqinj, Serbia, nuk është e interesuar për dialog me Prishtinën për çështje teknike as për dialog për statusin final të Kosovës, por thjeshtë, ajo është e interesuar për ta bërë ndarjen e Kosovës dhe një gjë të tillë është duke e treguar për çdo ditë.

Qëllimet e tilla të Beogradit janë të njohura për qytetarët e Kosovës, për subjektet politike dhe institucionet e saj. Natyrisht se janë të frikshme dhe në këtë drejtim kërkojnë ndihmë nga faktori ndërkombëtar dhe në veçanti nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Nju Jorku dhe Brukseli, që të mos lejojnë që shteti fqinj Serbia, të përdorë edhe më tutje Kosovën për ta instrumentalizuar në favor të politikës së saj. Dialogu duhet të shtrohet në një strategji të qartë institucionale ku kompetenca e institucioneve të Kosovës nuk do të vihet në dyshim.

Përmendja e Kosovës në preambulën e kartës kushtetuese Serbi-Mal i Zi, flet shumë qartë se Serbia nuk dëshiron të marrë mësim nga e kaluara.

Megjithkëtë, Qeveria e Kosovës, të gjithë energjinë e vet për vitin e ardhshëm qeveritar, gjegjësisht këtë vit, do ta fokusojë në zhvillim ekonomik, investime dhe hapje të vendeve të reja të punës me theks të posaçëm në bujqësi, sepse vetëm në këtë mënyrë do të kemi mundësi që të vijmë më shpejt deri te krijimi i vendeve të punës, në ndërtimin e mëtejshëm të administratës publike, në kyçjen dhe integrimin e komuniteteve pakicë, në veçanti të atij serb në të gjitha sferat e jetës, në funksionimin dhe zbatimin e ligjit në tërë territorin e Kosovës dhe në fillimin e ndërtimit të ministrive të reja.

Struktura ligjore do të bëhet prioriteti ynë i vazhdueshëm dhe do të bëjmë çmos që sa më shpejt të jetë e mundshme, ta bëjmë Kosovën me kushtetutën e saj, një vend ku funksionon dhe zbatohet ligji, ku të gjitha institucionet demokratike do të jenë

në shërbim të qytetarëve. Në këtë kuptim, do ta shtrojmë edhe marrjen e kompetencave nga UNMIK-u dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Në Kosovë s'mund të ketë pushtete paralele, përveç atij që ka legjitimuar vota demokratike e qytetarëve të Kosovës.

Ne mund t'ia dalim. Ne duhet t'ia dalim. Ne së bashku do ta bëjmë Kosovën.

Ju falemnderit për vëmendje.

(Duartrokitje)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Kryeministër, ju falemnderit për fjalën – raportin e paraqitur.

Kolegë deputetë, dëgjuam raportin e Kryeministrit për punën njëvjeçare të Qeverisë dhe vizionin e saj për këtë vit.

Në rrethana të rëndomta dhe normale, do të pasonte një debat konstruktiv, pyetje të caktuara të deputetëve dhe propozime të caktuara, në rrethanat që vepron Qeveria dhe institucionet, në kohën kur Kryeministri edhe në fjalën e vet të hapjes tha – një agjendë shumë e ndeshur e tij dhe e Qeverisë, në një proces jetik të Kosovës për asocime me Bashkësinë Evropiane. Unë do t'ju lutja që të kemi mirëkuptim për sot dhe që Kryeministrit t'i dëshirojmë punë të mbarë dhe të frytshme që e presin, kurse mbetet në obligim të Qeverisë dhe të Kryeministrit që në mbledhjet e ardhshme ose në formë të interpelancave që është e drejtë e deputetëve të kërkojmë në çdo mbledhje, ose në formë të vazhdimit, që do të merremi vesh më vonë, të vazhdohen debatet e rëndomta. Prandaj, do t'ju falënderoja për mirëkuptim dhe e di që me të drejtë keni mospajtime, por do t'ju lutja që të kemi një mirëkuptim. Urdhëro, profesor Hamiti.

SABRI HAMITI:

Zoti kryetar i Parlamentit, zoti Kryeministër, kolegë të çmuar,

Ne, si gjithmonë, kemi mirkuptime për të gjitha tipet e arsyetimeve dhe situatave që te ne quhen gjithmonë të sojit të veçantë dhe ne i njohim të gjithë bashkërisht. Unë

ju them, për vete, që është mirë të bëhemi serioz në punët që kemi përpara dhe t'i shikojmë këto probleme me seriozitetin më të madh edhe si organ përfaqësues edhe si organ përgjegjës të cilit, shyqyr zotit që më në fund, edhe Qeveria ka dalë e të thotë diçka për punën e vet.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju deklaroj që me përgjegjësi të mëdha kemi studiuar këtë paraqitje, sepse tekstin e kemi pasur në dorë përpara dhe kemi çka të bisedojmë.

Nëse kërkohet që, për mungesë të kohës së Kryeministrit, të mos bisedohet sot këtu, ne ruajmë të drejtën, qoftë në formë të një interpelance që unë e artikuloj që këtu sot rreth punës së Qeverisë që të bisedojmë patjetër në seancë tjetër. Sepse, kujtoj që duhet të jemi në nivelin e seriozitetit të përgjegjësive tona dhe të përgjegjësive të Kryeministrit dhe të Qeverisë së tij, ose tonën – si të doni quane.

Fjalimin, që dikush e quajti këtu raport e dikush ekspozë, unë e konsideroj të bukur, interesant, optimist, si tip të komunikimit publik. Por, jo referencial dhe jo analitik për një punë njëvjeçare në zbatimin e një programi të cilin e kemi deklaruar ne këtu dhe e kemi votuar para një viti.

Edhe një herë po them – nëse Kryeministri nuk ka mundësi të jetë këtu dhe të dëgjojë bisedimet tona, atëherë s'ka edhe objekt biseda pa te. Por, po them, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, qëtash kërktoj, që për këto punë të bisedohet një herë tjetër. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, zoti Hamiti.

Kryetarët e grupeve parlamentare me radhë, në qoftë se dëshirojnë. Urdhëro, në emër të Grupit Parlamentar, me autorizimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Berat Luzhës, e ka fjalën Hajredin Kuqi.

HAJREDIN KUQI:

I nderuar kryesues, i nderuar zoti kryeministër, të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës...

(Një deputet flet larg foltores – pak dëgjohe: - Si i thoni kryesues?! Është kryetar.)

HAJREDIN KUQI:

... Udhëroni! Më falni, a doni me ju dhënë sqarim juridik pse i them kryesues? Sepse, unë s'kam votuar për të, nëse veç doni.

... Në anën tjetër, mendoj se sa i përket ... Në qoftë se jeni të gatshëm me dëgjue, mund të bisedojmë.

Unë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që në fillim nuk kam përkrahur vonesën e Kryeministrit e që është vonuar sot deri në orën 11,30 nga se ne konsiderojmë që punët e Kryeministrit apo raporti i tij në Kuvend është raportim më me rëndësi për të dhe për Qeverinë dhe konsiderojmë se hapja e debatit lidhur me këtë çështje, për raportin apo ekspozueun, për të cilin mendojs e nuk u dhanë përgjigje pse kanë ndodhur disa gjëra dhe pse nuk kanë ndodhur dhe mbi të gjitha çka duhet të ndodhë në të ardhmen, konsideroj që kjo pikë e rendit të ditës duhet të diskutohet sot ose është dashur të shtyhet në tërësi. E kundërta e kësaj, tregoi një joseriozitet nga të gjithë, nga Qeveria por edhe nga ne që nganjëherë përqeshemi me njëri-tjetrin. Ky Kuvend është demokratik, secili ka të drejtë të flasë dhe mendojë si ia merr mendja.

Unë kërkoj, në emër të Grupit Parlamentar, që debati të vazhdojë sot, që të diskutohet me seriozitet. Ky debat do t'i kontribuojë edhe Qeverisë, edhe Kryeministrit edhe të gjithë tjerëve dhe do të fitojmë një traditë që udhëheqësit e institucioneve duhet t'i raportojnë këtij Kuvendi që i ka zgjedhur. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

E ka fjalën zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Sa i përket Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ne jemi të gatshëm që sot të marrim pjesë në debat rreth ekspozitës së Kryeministrit, jemi të gatshëm t'i japim vërejtjet tona për mospunën e Qeverisë dhe jemi të gatshëm t'i japim sygjyerimet për punën që duhet ta bëjë Qeveria në vitin vijues. Por, në rast se pajtohemi të gjithë që, për shkak të angazhimit të Kryeministrit sot, të mosë vazhdojë më debati, ne kërkojmë pra që në seancë ne ardhshme të jetë pikë e rendit të ditës e veçantë – debat rreth ekspozitës së Kryeministrit dhe mendojs e ajo do ta përmbledhte edhe këtë kërkesë të deputetëve. Si do që të jetë, ne dijmë se këto institucione janë ndërtuar me një marrëveshje për bashkëqeverisje por mendoj se edhe Qeveria edhe Kryeministri duhet të kenë zërin e partive politike për të vazhduar punën e mëtutjeshme, zërin e deputetëve. Kemi vërejtje, kemi sygjyerime për të ardhmen dhe kjo duhet të bëhet në seancën e ardhshme, në rast se pajtohemi dhe sot le të kalojë kjo kështu. Si do që të jetë, ne jemi të gatshëm për dy propozimet, por kjo do të varet edhe prej Kryeministrit nëse sot ka ngarkesë me angazhimet që përmendi dhe padyshim janë të rëndësishme edhe për Kosovën. Vendimi i të gjithëve do të jetë ai që do të vendosim. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Vetëm një sqarim. Dy grupe parlamentare kanë mirëkuptim për problemet e Kryeministrit. Urdhëroni zoti Sadik.

SADIK IDRIZI:

I u ime ostalih zajednica mislim da se ovo pitanje, znači izveštaj ili raport predsednika Vlade razmatra u njegovom prisustvu i u prisustvu barem većine ministara, jer postoje pitanja o kojima treba da se raspravlja i o dosadašnjem radu a i o onome što predstoji pred Vladu za naredni period. Mi ćemo podržati znači i da se odloži kompletna rasprava za neku od sednica, mislim za prvu sednicu koja je u neko vreme znači adekvatno ali da bude prisutan i predsednik Vlade i onaj deo ministara kojima treba da se upute odredjene stvari. Hvala.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Mendoj se është e qartë. Zoti Kryeministër urdhëroni.

BAJRAM REXHEPI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Unë me seriozitetin më të madh edhe kam bërë ofertën dhe para se të kërkojë Kuvendi. E di obligimin tim edhe sipas Kornizës kushtetuese që minimum-një herë në vit duhet të jipet raport. Në atë mënyrë edhe kam vepruar dhe kjo mund të quhet më tepër një rezyme për arsye që kam menduar se do ta bëjmë një raport pune të detajizuar që do të përfshijë 200-300 faqe dhe mendoj se do t'ua humbte kohën edhe juve. Mirëpo, nëse ju mendoni kështu, atëherë mund ta bëjmë në ndonjëherë, me siguri nuk mund ta bëjmë në seancën e ardhshme, por për 2-3 javë mund ta kompletojmë dhe t'ua çojmë në 3 gjuhët dhe atëherë të debatojmë taman për punën complete. Unë jam në dispozicion, sepse për mua sigurisht është organi më i lartë legjitim në Kosovë Parlamenti por edhe kjo është e një rëndësie të posaçme mekanizmi i stabilizim-asocimit ku kemi pasë pengesa shumë të mëdha që Kosova të shkojë me rrugën e vet ndaras dhe tendenca ka qenë që të shkojmë bashkërisht me ish Jugosllavinë prandaj kemi pasur sukses dhe tash edhe atje bijmë pak joserioz nëse në fjalën përfundimtare s'marrim pjesë dhe ta bëjmë një komunikatë të përbashkët. Megjithatë, jam në dispozicionin tuaj. Nëse mendoni se duhet sot të debatohet lidhur me këtë unë jam i gatshëm dhe qëndroj i gatshëm. Nëse mendoni se mund të shtyhet për javën e ardhshme dhe atëherë t'i kemi komplet edhe ministrat sepse jemi të gjithë së bashku Qeveri dhe për shumë çështje mund të debatoj por ka çështje që duhet në mënyrë specifike ministrat dhe kërkoj mirëkuptim që për javën e ardhshme të jemi në dispozicion komplet.

Edhe një çështje, sa i përket kësaj koincidence, unë kam qenë i gatshëm për javën e kaluar, por si gjithnjë ne jemi në krijimin e eksperiencës në çështje procedurale si Kuvendi po ashtu edhe Qeveria dhe ndodh që s'e kemi bërë përgatitjen, sepse është ekspozë dhe do të jetë përkthimi simultan, nuk do të jetë i obligueshëm, por pastaj pas vërejtjeve ne bëjmë atë përkthim kështu që vendosni ju për këtë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Kryeministër, ju falemnderit. Punë të mbarë ju dëshirojmë në bisedat që keni të rëndësishme për Kosovën. Ne do të shihemi në mbledhjet e ardhshme.

(Duartrokitje)

Ne jemi marrë vesh në Kryesi, për një propozim edhe të institucioneve këshilldhënëse që veprojnë në Kosovë, që rendin e ditës të seancës së ardhshme plenare t'ua tregojmë që sot.

Prandaj, pikë e parë e rendit të ditës të seancës së ardhshme plenare do të jetë:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për farërat;

Dhe pikë e dytë:

- Shqyrtimi i Inisiativës për shpalljen e Bjeshkëve të Nemura Park Nacional.

Ndërsa çështjen e vazhdimit të debatit, meqë nuk ka qenë e diskutueshme, ne mund ta fusim në Kryesi në mbledhjen e ardhshme.

Po ju informoj se pyetjet e deputetëve, që me të drejtë i keni parashtruar, nuk kanë arritur përgjigjet me kohë, por që shërbimit të Sekretarisë i janë proceduar me kohë, prandaj nuk mund t'i kemi përgjigjet kësaj radhe.

Ju falemnderit dhe mirëupafshim në seancën e ardhshme të Kuvendit.

Seanca përfundoi në orën 12,30.